



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE, STREHIMIT DHE SHËNDETIT PUBLIK

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al

Nr. ____ Prot.

Shkodër, më ____/____2019

Lënda: Jepet informacioni i kërkuar

e-mail: _____

Në përgjigje të kërkesës suaj me Nr.14/19, datë 08.10.2019, regjistruar në Bashkinë Shkodër me nr.17185 prot, datë 10.10. 2019, ju informojmë si më poshtë:

- Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve është një strukturë brenda Drejtorisë së Shërbimeve Sociale të Bashkisë Shkodër dhe ka në përbërje 10 punonjës social.
- Numri i rasteve të trajtuara nga Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve për periudhën nga data 01.01.2018 – 01.10.2019 është 270 fëmijë.
- Numri i fëmijëve në konflikt me ligjin të trajtuara nga Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve për periudhën nga viti 2018 – 2019 është 4 fëmijë.
- Numri i fëmijëve, viktimë dhe/ose dëshmitar i veprave penale të trajtuara nga Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve për periudhën nga data 01.01.2018 – 01.10.2019 është 2 fëmijë.
- Numri i rasteve të trajtuara nën mbikqyrjen e Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijëve, ndaj të cilëve është dhënë masë detyruese sipas nenit 68 të Kodit të Drejtësisë Penale për të mitur është 1, i mitur.
- Sa i takon masave detyruese të vendosura nga organi procedures, të mbikqyrura nga NJMF, është: - “Ndjekja e procesit mësimor nga i mituri”, procedurë e realizuar në bashkëpunim me Shërbimin e Provës, Shkodër dhe me psikologun e shkollës që ka frekuentuar i mituri.
- Numri i rasteve të trajtuara nga punonjësi për mbrojtjen e fëmijëve, i cili është përcaktuar si përfaqësues procedural sipas nenit 74 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur për periudhën nga viti 2018 – 2019 është vetëm një rast.

Për sa i përket vënies në dispozicion të dokumentacionit, bazuar në ligjin Nr.18/ 2017 “ Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” Neni 17 dhe Ligji nr.9887 i ndryshuar “ Për mbrojtjen e të dhënave personale” ju bëjmë me dije që dokumentacioni për të miturit që trajtohen nga punonjësit për mbrojtjen e fëmijëve, ruhet për fëmijët në dosjen përkatëve dhe janë konfidenciale.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

KRYETAR

Voltana Ademi